Ai që bën mirë në Islam, nuk do të llogaritet për veprat e periudhës paraislame, ndërsa ai që bën keq në Islam, do të llogaritet edhe për të parat, edhe për të fundit.”

Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se një person pyeti: "O i Dërguari i Allahut, a do të merremi në përgjegjësi për atë që e kemi vepruar në periudhën paraislame?" Profeti ﷺ tha: “Ai që bën mirë në Islam, nuk do të llogaritet për veprat e periudhës paraislame, ndërsa ai që bën keq në Islam, do të llogaritet edhe për të parat, edhe për të fundit.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith e sqaron vlerën e hyrjes në Islam, rrjedhimisht, kushdo që bëhet musliman, e zbaton mirë Islamin, është i sinqertë dhe e i çiltër; nuk do të llogaritet për gjynahet që ka bërë gjatë periudhës paraislame (para ardhjes së Profetit ﷺ). E, kushdo që bën keq në Islam, duke qenë hipokrit ose duke dezertuar nga feja; do të llogaritet për atë që ka bërë teksa ishte jobesimtar dhe për atë që ka bërë duke qenë musliman.

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65002

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY
لجنة الدعوة الإلكترونية
EDC E-Da'wah Committee